

## REGJIME PËR SEKTORË TË VEÇANTË

### Furnizimi i cigareve

Referuar dispozitave të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për qëllime të tregtimit të cigareve, operatorët e mëposhtëm zbatojnë skemën e deklarimit dhe pagesës së TVSH-së në një fazë të vetme. Për këtë qëllim, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- "Furnizues kryesorë" konsiderohen importuesit dhe prodhuesit vendas të cigareve.
- "Furnizues të ndërmjetëm" konsiderohen tatimpaguesit që furnizohen me qëllim për të rishitur te furnizues të tjerë të ndërmjetëm dhe/ose te njësitë e shitjes me pakicë.
- "Njësi të shitjes me pakicë" konsiderohen tatimpaguesit që furnizohen për të shitur te blerësit, konsumatorë finalë.
- "Furnizim i parë" është furnizimi që furnizuesi kryesor bën për furnizuesit e ndërmjetëm apo për njësitë e shitjes me pakicë.
- "Çmim i shitjes me pakicë" është çmimi i paguar nga blerësi, konsumator final.

TVSH për cigaret paguhet tërësisht nga “Furnizuesi kryesor” në “Furnizimin e parë”. Furnizuesi kryesor e llogarit TVSH-në mbi vlerën e tatueshme të bazuar në çmimin me pakicë për çdo furnizim të kryer. Furnizuesi kryesor zbrit direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg për të gjithë furnizuesit e mëvonshëm pa ndikuar TVSH-në e llogaritur.

#### ***Kujdes!***

*Blerësi i parë, qoftë ai “Furnizues i ndërmjetëm” ose “Njësi e shitjes me pakicë”, që merr furnizimin nga “Furnizuesi kryesor”, nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e faturuar në faturën e lëshuar prej “Furnizuesit kryesor”. Furnizimi i cigareve në vazhdim nga furnizuesit e ndërmjetëm, do të kryhet pa llogaritur TVSH në faturë pasi TVSH-ja është paguar nga “Furnizuesi kryesor” bazuar në çmimin e shitjes me pakicë, i cili është edhe çmimi përfundimtar i këtij artikulli tek konsumatori final.*

## Çmimi maksimal

“Furnizuesi kryesor” përcakton çmimin maksimal të shitjes me pakicë të cigareve dhe është i detyruar ta deklarojë atë çmim në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar, jo më vonë se 10 ditë para datës së aplikimit të çmimit të ri. “Furnizuesi kryesor” është i detyruar të publikojë deklaratën e ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete në jo më pak se dy gazeta ditore kombëtare dhe jo më vonë se 5 ditë nga data e aplikimit të çmimit të ri. Për efekte marketingu çmimet maksimale mund të vazhdojnë të publikohen në çdo media të shkruar apo elektronike për aq kohë sa ato çmime janë në fuqi.

## Faturimi i furnizimit

- Furnizuesi Kryesor furnizon një Furnizues të Ndërmjetëm (Rishitës). TVSH-ja deklarohet dhe paguhet normalisht nga Furnizuesi Kryesor. Po në këtë faturë, Furnizuesi Kryesor zbrit vlerën e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse, pa ndikuar në TVSH-në e llogaritur. Furnizuesi i ndërmjetëm nuk ka të drejtë të zbrisë TVSH-në.
- Furnizuesi Kryesor furnizon Njësinë e Shitjes me Pakicë. TVSH-ja deklarohet dhe paguhet normalisht nga Furnizuesi Kryesor. Po në këtë faturë, Furnizuesi Kryesor zbrit vlerën e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse, pa ndikuar në TVSH-në e llogaritur. Njësia e Shitjes me Pakicë nuk ka të drejtë të zbrisë TVSH-në.
- Furnizuesi i Ndërmjetëm furnizon Njësinë e Shitjes me Pakicë. Faturimi bëhet duke lëshuar faturë tatimore me çmimin final pa aplikuar TVSH, duke zbritur vlerën e ndërhyrjes në treg të hallkës pasardhëse (pra të njësisë së shitjes me pakicë).

## Rregulla të përgjithshme

- i) Furnizuesi kryesor është i detyruar të publikojë deklaratën e ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete, në jo më pak se dy gazeta ditore kombëtare dhe jo më vonë se 5 ditë nga data e aplikimit të çmimit të ri.
- ii) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është e detyruar të publikojë në faqen e saj të internetit çmimet e reja maksimale të shitjes me pakicë të cigareve jo më vonë se dy ditë para datës së zbatimit të çmimeve të reja.
- iii) Ndalohet shitja e cigareve me çmim më të lartë se çmimi maksimal i shitjes me pakicë, i deklaruar dhe publikuar prej “Furnizuesit Kryesor” dhe i publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
- iv) Furnizuesit e ndërmjetëm dhe njësitë e shitjes me pakicë të cigareve janë të detyruar të dokumentojnë të gjitha shitjet e cigareve të kryera me fatura tatimore apo kupon tatimor fiskal.